



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1091_02_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 27.02.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 prill 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHE** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. R. (parashtruesi i ankesës I. R.) me shifër të konsumatorit: DPR – 40637) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1091_02_14 i datës 11.02.2014.

Arsyetim

Me datë 29.10.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit është konstatuar nga lexuesi i KEK-ut, se prej që e lexon këtë pikë matëse nuk e ka gjetur këtë konsumator, dhe është konstatuar se kjo shifër duhet të pasivizohet. Pas kësaj konsumatori me datë 29.10.2011 ka bërë kërkesë në KEK, Divizioni i Rrjetit, me të cilën ka kërkuar nga KEK-u, që ti mundësoj konsumatorit lidhje të re.

Me datë 21.11.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut, nga Divizioni i Rrjetit sipas kërkesës së konsumatorit kanë dalë në pikën matëse të konsumatorit, ku kanë bërë pranimin e instalimit të rrjetit elektrik në këtë pikë matëse, si dhe kanë regjistruar edhe pajisjet që posedon konsumatori. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë instalimin e njehsorit të ri elektrik me numër 9198710, si dhe është konstatuar se njehsori i vjetër nuk prezantohet nga ana e konsumatorit. Punëtorët e autorizuar të KEK për inspektimin e pikave matëse kanë konstatuar se në pronën e cila është kërkuar lidhja e re ekziston edhe një shifër tjetër e vjetër: #40637.

Konsumatori ka prezantuar dokumentin e lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Urbanizmit dhe Ndërtimitari e Komunës së Prishtinës me të cilën vërteton se A. R. i cili është pronar i shtëpisë (tipi) P+2 nga fshati Bardhosh është e dëmtuar djegur objekti dhe nga konstatimi i komisionit është se shkalla e dëmtimit i takon kategorisë së IV dhe propozohet ndërtim i ri. Konsumatori ka prezantuar dokumentin e lëshuar nga Drejtoria e Administratës dhe Personelit, përkatësisht Bashkësia Lokale Bardhosh me të cilën vërtetohet se në bazë të kërkesës së A. R. nga Bardhoshi i lindur me 25.07.1945



vërtetohet se është banor i kësaj bashkësie lokale si dhe konstatohet se shtëpia e tij është djegur gjatë periudhës së luftës dhe nuk ka mund të kthehet të jetoi deri në tetor të vitit 2002.

Me datë 07.10.2013 konsumatori ka bërë kërkesë në KEDS me të cilën ka kërkuar nga ta, që të kontestohet borxhi i ngarkuar nga një shifër tjetër të cilin borxh konsumatori thekson se ai personalisht nuk e ka krijuar, por që i njëjti figuron në emër të prindit i cili ka jetuar në një pronë tjetër.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 10.10.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kundërshtuar bartjen e borxhit nga një pikë matëse në pikën tjetër si lidhje e re. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 11.02.2014 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS që: 1) KKDFE duhet t'i mundësoi lidhje të re konsumatorit I. R. duke i hapur shifër të re, ashtu siç përcaktohet me procedurat ligjore. 2) KKDFE duhet të kërkoj borxhin e krijuar në shifrën e konsumatorit **DPR - 40637** dhe këtë borxh ta kërkoj në procedurë gjyqësore, pranë gjykatës kompetente. 3) Të gjitha faturat e energjisë elektrike dhe pagesat e bëra nga muaji 12/2011 e tutje t'i barten në shifrën e re.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës pasi që në bazë të shkresave të lëndës shihet se te ky konsumator nuk kemi të bëjmë me bartje të borxhit nga se shpenzimi deri në muajin maj 2013 është bërë konform leximit të njehsorit me nr. 9198710. Pika 2 e kundërshtimit të KEDS është se në raporte kontraktuese është A. R. e jo parashtruesi i ankesës I. R. për të cilin KEDS-i nuk ka kurrfarë dijenie se në çfarë raportesh qëndron me kontraktuesin.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 prill 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit se te konsumatori nuk kemi të bëjmë me bartje të borxhit pasi që ky shpenzim është bërë konform leximit të njehsorit elektrik. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se një vlerësim i tillë nuk është i arsyeshëm pasi që te ky konsumator janë bartur të gjitha lëshimet e bëra nga ana e KEK më herët si për mos inkasim të borxhit ashtu edhe për faturim të parregullt dhe si rezultat i gjithë kësaj ka ardhur deri te kushtëzimi i konsumatorit të ri I. R. që të paguaj borxhin e shpenzuar nga dikush tjetër në mënyrë të kundërligjshme duke mos i dhënë edhe lidhje të re. Bordi ka analizuar edhe dëshmitë e prezantuara nga ana e konsumatorit të lëshuara nga organet e administratës lokale me të cilat vërtetohet se parashtruesi i ankesës I. R. se cilin vendbanim e ka pasur deri në periudhën kontestuese.

Sa i përket pikës 2 të kundërshtimit se KEDS-i nuk është në dijeni se në çfarë raportesh qëndron konsumatori A. R. dhe parashtruesi i ankesës I. R. Bordi i ZRRE-së edhe për këtë pikë ka konstatuar se në bazë të ligjeve dhe rregullave në fuqi KEDS është i obliguar të faturojë çdo konsumator sipas shpenzimit mujor që bënë, ndërsa për borxhin e pa inkasuar nuk ka të drejt ligjore t'ia bart dikujt tjetër që nuk e ka krijuar.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*.

Gjithashtu neni 5 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“furnizuesi duhet të faturojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve, andaj KEK në këtë rast nuk ka vepruar konform kësaj dispozite pasi që nuk ka arrit të inkasoj borxhin e krijuar ashtu siç përcaktohet me këtë rregull”*.



Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1091_02_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar